



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI

KONTRATË SHËRBIMI

Palët

Kuvendi i Shqipërisë, me adresë në Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 4, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Genci Gjonçaj, Sekretari i Përgjithshëm, në vijim referuar si “**Kërkuesi i Shërbimit**”;

Dhe

..... shtetase shqiptare, lindur më mbajtëse e kartës së identitetit me nr., person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, në vijim referuar si “**Ofruesi i Shërbimit**”, *këtu e tutje referuar individualisht si "Pala" dhe së bashku si "Palët"*, (bashkëlidhur ID kësaj kontrate).

Sot në datën, midis palëve lidhet kjo kontratë shërbimi me kushte si vijon:

DUKE PASUR PARASYSH SE,

Byroja e Kuvendit, bazuar në Vendimin nr.50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “*Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian*”, referuar në këtë kontratë Komisioni i Posaçëm Parlamentar, me vendimin nr.90 datë 20.11.2024, pika 2, ka miratuar tabelën e klasifikimit dhe mënyrën e pagesës së ekspertëve për periudhën 2024-2025.

Byroja e Kuvendit me vendimin nr. 95, datë 04.12.2024, pika 2 e saj ka vendosur: “*Miratimin e masës së shpërblimit për çdo ekspert sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi*”, pra masa e pagesës për ekspertin gjendet në listën bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 1

Objekti i Kontratës së Shërbimit

Objekti i kësaj Kontrate është ofrimi i ekspertizës dhe shërbimit të konsulencës për Komisionin e Posaçëm Parlamentar sipas të drejtave dhe detyrimeve reciproke dhe vlerës financiare të përcaktuara në këtë Kontratë.

Neni 2

Të drejtat dhe detyrat e ofruesit të shërbimit

2.1 Ofruesi i shërbimit angazhohet si ekspert/e për të realizuar:

- a) një analizë të situatës aktuale në fushën e: **Parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit**, në të cilën Komisioni është i angazhuar duke u mbështetur kryesisht në gjetjet dhe rekomandimet e shprehura në Raportet e BE-së, përmes një angazhimi gjithëpërfshirës;
- b) hartimin e masave, pjesë e një Plani Kombëtar Veprimi, me kohështirje afatgjatë dhe të qëndrueshme për adresimin e sfidave përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë që i është caktuar në pikën e mësipërme ;
- c) propozimin dhe ndërmarrjen e masave konkrete për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale, të cilat duhet të adresohen në secilën fushë nga institucionet përgjegjëse;
- d) ekspertizë në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë kontratë.

2.2 Gjatë ofrimit të shërbimit ofruesi duhet:

- a) të përmbushë kriteret e profesionalizmit, objektivitetit dhe paanshmërisë.
- b) të jetë i pranishëm në mbledhjet e Komisionit të Posaçëm Parlamentar;
- c) të mbështesë anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar me këshillim;
- d) t'i përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për çështje të ndryshme ligjore në lidhje me objektin e veprimtarisë së Komisionit.
- e) të hartojë analizat përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë që ju është caktuar;
- f) të marrë pjesë në diskutimet e analizës dhe problematikave të ngritura në grupet e punës;
- gj) të hartojë përmbledhjet ekzekutive sipas fushës së përgjegjësisë që ju është caktuar;
- g) të hartojë dhe prezantojnë analizat sipas ndarjes së fushave në tryezat e hapura publike, të organizuara në Tiranë;
- h) të hartojë dhe prezantojnë analizat sipas ndarjes së fushave në forumet e hapura publike, të organizuara nëpër rrethe me grupe të ndryshme interesi;
- i) të reflektojë komentet dhe sugjerimet e ngritura në tryezat dhe forumet e hapura publike;
- j) të adresojë komentet e ekspertëve të tjerë kombëtarë (të diasporës) dhe ndërkombëtar;
- k) të finalizojë Dokumentin Analitik sipas fushës së përgjegjësisë që i është caktuar.

2.3 Ofruesi i shërbimit përgjigjet individualisht dhe mban përgjegjësi për respektimin e legjislacionit për konfliktin e interesit si dhe për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi.

2.4 Shërbimet e ofruara në përputhje me këtë nen nuk mund të publikohen ose t'i bëhen të ditura personave të tretë pa pëlqimin dhe miratimin paraprak të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

2.5 Çdo veprim në kundërshtim me këtë parashikim përbën shkelje të kushteve të kontratës.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrat e Kërkuesit të Shërbimit

3.1 Kërkuesi i Shërbimit merr të gjitha masat për të krijuar kushtet e nevojshme për ofruesin e shërbimit në përmbushjen e detyrave të tij.

3.2 Kërkuesi i Shërbimit do të ekzekutojë kryerjen e pagesës pasi të ketë marrë zyrtarisht nga Kryetari i Komisionit të Posaçëm Parlamentar informacionin për angazhimin dhe realizimin e detyrave të përcaktuara si ekspert për ofruesin e shërbimit.

Neni 4 **Kohëzgjatja e kontratës**

Kjo kontratë konsiderohet e lidhur për efekt financiar që nga momenti kur ofruesi i shërbimit ka marrë detyrën nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar deri në realizimin e saj, gjithmonë brenda afatit të veprimtarisë së këtij Komisioni.

Neni 5 **Pagesa për shërbimin e ofruar dhe mënyra e ekzekutimit**

5.1. Ofruesi i shërbimit do të paguhet sipas përcaktimeve të Vendimit të Byrosë së Kuvendit nr. 95, datë 04.12.2024. Për efekt pagese eksperti/ja _____, do të paguhet me 3 (tre) paga me 100% të pagës mujore bruto për pozicion të këshilltarit të komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë. Kjo pagesë i nënshtrohet legjislacionit tatimor në fuqi, për tatimin në burim

5.2 Pagesa do të bëhet në llogarinë bankare në bankën _____ kundrejt vërtetimit bankar i cili duhet të përfshijë të dhënat si më poshtë:

- Përfituesi:
- Nr. llogarisë bankare IBAN:Swift
- Monedha: Lek /monedhë e huaj
- Emri i bankë së përfituesit:
- Adresa e Bankës:

Neni 6 **Zgjidhja e kontratës**

6.1 Kërkuesi i shërbimit ka të drejtë të zgjidhë kontratën përpara afatit të përcaktuar në rastet e mëposhtme:

- a) Kur ofruesi i shërbimit shkel klauzolat e parashikuara në këtë kontratë ose largohet;
- b) Kur ofruesi i shërbimit manifeston paaftësi apo neglizhencë profesionale në kryerjen e detyrës që ka marrë përsipër;
- c) Në rastet kur si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të ofruesit të shërbimit Komisioni i Posaçëm ka pësuar një dëm moral ose material;
- d) Si dhe për çdo shkak tjetër të parashikuar me ligj.

6.2 Në rast se ofruesi i shërbimit nuk mund të realizojë shërbimin deri në fund, ai/ajo duhet të njoftojë kërkuesin e shërbimit në një kohë të përshtatshme, jo më vonë 1 javë para zhvillimit të mbledhjes së Komisionit.

6.3 Në çdo rast të zgjidhjes së njëanshme të kontratës, palët duhet të respektojnë afatin e njoftimit të paktën 3 ditë pune para ditës së zgjidhjes.

Neni 7
Produkti i kontratës

Ofruesi i shërbimit pranon se pronësia intelektuale në kuadrin e kryerjes së shërbimeve e kryer kjo individualisht apo në bashkëpunim me ofruesit e tjerë (produkti i punës), është pronë dhe i përket ekskluzivisht Kuvendit.

Neni 8
Kushte të tjera

8.1 Kërkuesi i Shërbimit ruan të drejtën e mospagimit të shumës të përcaktuar në nenin 5 në rast të largimit të ekspertit ose të shkeljes / mosplotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

8.2 Çdo heqje dorë nga të drejtat, zgjidhje e kontratës apo ndryshim i kushteve të saj duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga palët e kontratës.

Neni 9
Dispozita të fundit

9.1 Për çdo gjë tjetër që nuk është shprehur në këtë kontratë do të zbatohen rregullat e përgjithshme të kontratave të parashikuara në nenet 659 – 704 të Kodit Civil si dhe legjislacioni përkatës në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

9.2 Kjo kontratë është redaktuar në tre kopje, me tekst të barabartë dhe pasi lexohet nga palët firmoset prej tyre.

OFRUESI I SHËRBIMIT

KËRKUESI I SHËRBIMIT

Genci GJONÇAJ